



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Beledijesi

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01.nr. 16-126211 datë 06.11.2014, dhe në zbatim të nenit 3 paragrafi 3 të Rregullorës për ndarjen e subvencioneve 01.Nr. 016-126422 e datës 29.12.2016, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2017, merr

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve dhe shërbimeve tjera të Shoqatës së të Verbërve Gjiçan

1. Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në shumën prej 5,000.00 € për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve në Gjiçan për vitin 2017
2. Shoqata e të Verbërve në Gjiçan është e obliguar që të paraqes projekt propozimin në të cilin duhet të përshkruhen aktivitetet me agjendë të planifikuar dhe të specifikuar në mënyrë financiare
3. Shoqata e të Verbërve është e obliguar që të bëjë përmbylljen mjeteve të shpenzuar dhe për këtë të ofroj dëshmi në mënyrë që të përfitoj nga ky subvencionim
4. Mjetet financiare ndahen nga Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale -kategoria e shpenzimeve të Subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset ekzekutivi i Komunës, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK-Gjiçan.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr. 016-43336
Gjiçan, më 28.04.2017

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi